


FOUR ALBANIAN VILAYETS DURING THE OTTOMAN EMPIRE (until 1878)



The Frosina Foundation/ 100 Boylston St./Boston, MA 02116/Tel: 617/482-2002/Fax: 617/482-0014

SHQIPËRIA NË SHEK. XIX
*
ALBANIEN PÅ 1800-TALET
*
ALBANIA IN XIX CEN.

Revistë kulturore-informative

Shoqata Besa, në Trelleborg - Suedi


Kultur- och informationstidskrift

Föreningen Besa i Trelleborg - Sverige

DRITA

Viti V
Nr.26/2000
Çmimi
30:- (korona)

Ç'U BË ME MITROVICEN?



Bernar Kushner

VAD HÄNDE MED MITROVICA?

DRITA

Viti V

(Numri i parë i Dritës doli në maj të vitit 1966)

Kryeredaktor: Chefredaktör:
SHEFKI OSEKU

Redaksia:

Mustafë Bahtiri
Naser Hajzeri
Shqiptar Oseku

BASHKËPUNËTORË:

Hajdin Abazi
Zeçir Rama
Ullmar Qvick
Hazyr Dervishi
Shefqet Cakiqi
Rizah Sheqiri
Shefqet Jashari
Fadil Shyti

Kompiuterizimin:

Frashër Oseku

ADRESA / ADRESS:

DRITA
C/O Shefki Oseku
Hamngatan 24
231 42 TRELLEBORG
SWEDEN
Tel: (0) 410 - 182 66
Fax: (0) 410 - 413 13

e-mail:

revista_drita@hotmail.com

Drita në internet:

http://home.bip.net/drita

Pagesa bëhet në:

FöreningsSparbanken:
(8214 - 9)
984.925.066-8

Dorëshkrimet e fotografitë nuk
kthehen

Redaksia mbanë drejtën e
redaktimit.

Përgjegjësinë për shkrime e mbanë
autori i shkrimit

Ansvarig för texten är:
Skrivbenterna

Shqiptar Oseku:

V E T Ë R R Ë F I M

Zotynë

*dorën e ndihmës më shtrij
ta mund atë tjetrin brenda meje*

*për çdo mbrëmje më ngulfasin
duart e akullta të zisë*

*përmbytje penestesh dokleatesh japodesh
në miniatyrë*

*druaj që s'nxjerr dot
poezinë e vërtetë*

Zotynë

*i druaj një nate të pahënë
kur do të më vjedhin edhe poezinë
hajnnjerëzit*

Nga përmbledhja me poezi "KRYQESI I SHPIRTIT"



Trelleborg

DRITA nr.26/2000

NË GAZETAT E TRELLEBORGUT



Shkruan: Frashër OSEKU, Suedi
frasher_oseku@yahoo.com

Me datën 06.02.2000 dhe me 07.02.2000 në të dyja gazetat e Trelleborgut, "Trelleborgs Allehanda" dhe "Arbetet" u botuan dy artikuj, për SHKSH "BESA" të Trelleborgut të Suedisë.

**TA TRELLEBORGS
ALLEHANDA**
LOGU I GAZETËS TRELLEBORGS
ALLEHANDA

Arbetet.
LOGU I GAZETËS ARBETET

Në gazetat e lertëpërmendura u shkrua për SHKSH "BESA" të Trelleborgut, e ku flitej se si Shoqata BESA me financimin e vet e kishte organizuar mësimin plotësues për fëmijët shqiptarë që janë të dobët në matematikë.

Arsimtari Mustaf Bahtiri, ekonomist i diplomuar, pa pagesë, vullnetarisht, vendosi që fëmijët shqiptarë të mos ngelin prapa. Ky, me punën e vet, bëri që nxënësit shqiptarë, të cilët janë të dobët në matematikë, ta ushtrojnë matematikën gjatë të shtunës dhe të dieles, vetëm e vetëm që nxënësit ta kalojnë klasën e nëntë dhe të arrijnë për t'u regjistruar në gjimnaz.

Në të dyjat gazetat e Trelleborgut kishin bërë intervistë me kryetarin e SHKSH "BESA" në Trelleborg, ku flitej se si kryetari i "BESËS" i kishte hapur dyert e shoqatës për nxënësit shqiptarë.

... "Skola
under
helgen ska
göra barn
bättre i
matte"...



Kryetari Shefki Oseku me
disa nga nxënësit shqiptarë

Mësuesi i matematikës
Mustaf Bahtiri

Trelleborgs
Allehanda
07.02.2000

Fotot janë të marrura në gazetën "TRELLEBORGS ALLEHANDA"

... "De
pluggar
matte -på
helgen"...

Arbetet
06.02.2000

Në këto gazeta u folën fjalët më të mira për këtë akcion arsimdashës të shqiptarëve të Trelleborgut. Kryetari i SHKSH "BESA" ka kërkuar tek shqiptarët e Trelleborgut, por edhe tek shqiptarët që jetojnë afër këtij qyteti që t'u ndihmojnë fëmijëve tanë në anglisht, dhe suedisht, të vijnë dhe të arsimojnë fëmijët shqiptarë të Trelleborgut.

herë parullat në mur, pikërisht ditën e Një Majit: "Rroftë flamuri kuq e zi në zemrat e shqiptarëve!"

Popull i burgosur, i feksi në tru. Popull që e shkruan emrin në dritare burgjesh, tek e shikon qiellin nëpër grila.

Ja, mësuesi im, dje ti e pas gjashtë vjetësh unë, nxënësi yt. I tillë qenka fati ynë, tha ndër dhembë i prekur thellë.

Iu soll edhe një herë ndërmend dita kur i arrestuan të dy mësuesit. Pastaj, iu kujtua se si mësuesi Bekim me të fejuarën e tij, çdo të diele, dilnin së bashku në korzo. Ajo që femër jashtëzakonisht e bukur, gracioze, e që dukej si një gonxhe e posaçelur. Por, pas burgosjes së mësuesit, ish tretur e fishkur nga pikëllimi.

Sigurisht se Doruntinën time do ta pres i njëjti fat, mendoi ai me mallëngjim.

Ofshau thellë. Iu kujtua një film amerikan, i cili kohë më parë që shfaqur në kinemanë e qytetit. Një djalë e kish humbur udhën në shkretëtirën e Saharës. I eçtuar pamasë, ai shihte ëndrra me sy çelur, se si gjoja po i afrohej një oaze. Vraponte nxitueshëm nëpër rërë, por mu atëherë kur shkonte te burimi, oaza i tretej si ëndërr.

Ja, pikërisht e tillë qenka jeta nën robëri, gjykoi pikëllueshëm. Kur mendon se je afër zenitit, kur je duke ia dhënë dorën e fundit poezive dhe me padurim pret ta dorëzosh përmbledhjen e parë në shtyp, befas një fshesë e hekurt të gllabëron me dhunë, të hedh në pusin e shoqërisë, prej nga pastaj nuk dilet dot.

Arbeni nuk kish dyshim se burgu do të vazhdonte edhe jashtë, nëqoftëse do ta lironin një ditë. Diç në zemër e sëmboi. Iu kujtua biseda me njërin nga redaktorët e revistës "Jeta e Re". Ai ia kishte parë dhe pëlqyer poezitë. Duhej t'i latonte vetëm edhe disa

vargje dhe, përmbledhja ishte gati për botim. Madje, ai ia pëlqeu edhe titullin që e kish gjetur: "Një lloj drite tjetër". Titull mjaft simbolik, i kishte thënë ai. Titull që s'do ta shihte dritën kurrë.

U ul në dysheme.

Atypëraty vendosi ta ndërrojë këtë temë. Vetlëndimi, në rrethanat në të cilat ndodhem unë, është marri, për të mos thënë qyqari, u nevrkos në vetveten.

Një kohë të gjatë u kujtua.

Edhe pse e pati vështirë, e gjeti fillin e mendimeve, prej të cilave padashur që ndarë.

I vetmi mendim me peshë në këtë çast është parashikimi i veprimeve të ardhshme të UDB-së, gjykoi ai. E pa si të udhës që, për një moment, t'i mbyll sytë e të pres një "urdhër" të brendshëm. Pas disa sekondave, iu bë se ia arriti të përqëndrohet në temën që donte ta shtjellojë. Iu duk se do të ishte me vend për ta bërë bilansin e këtyre ditëve: që nga arrestimi e deri me sot.

Ndonëse fizikisht ishte i molepsur, Arbeni vendosi të thellohet në mendime. Para syshë iu shfaq përsëri fytyra e elegantit, këtë herë me një zymti kërcënuese. Ndjeu se si diçka iu mblodh kruspull në zemër. Duhet të mendoj tashti, që të mos kem nevojë të mendoj më vonë, vendosi ai prerazi.

Ia nisi ta analizojë me kujdes jetën e vet, si dhe rrethanat që e sollën këtu.

Së pari, më së miri do t'ishte sikur populli im të mos ish i robëruar, u mundua të gjykojë nga fillimi. Nuk do të kish nevojë për t'u arrestuar njeri, pra as unë. Por, meqë gjendja është siç është, atëherë edhe kjo përvojë imja e hidhur i ka disa përparësi. S'ka të keqe pa një të mirë. UDB-a m'i ka hapur sytë me gozhdë.

(- vijon në numrin e ardhshëm -)

Prova gjenerale: Mitrovica në flakë



Shqiptar OSEKU
oseku@hotmail.com

Sh përthimi i dhunës në Mitrovicë mund të quhet i shëmtuar, prekës, çmeritës. Opinioni perëndimor, të mësuar me tjera skema, seria e përlëshjeve të përgjakshme gjatë javës mund t'i është dukur spontane. Ekstremistët shqiptarë e goditin me tromblon një autobus serb diku ndër fshatra, ekstremistët serbë në Mitrovicë ahmirren duke hedhur bomba dore kundër shqiptarëve, dhe frik, kursi i ngjarjeve u ikë prej duarve ekstremistëve të të dy palëve. Scenário klasike, pra, sikur të ish kopjuar prej indigos irlandeze. Veçse Kosova nuk është Irlandë. Në Kosovë s'bëhet fjalë për përlëshje të dy komuniteteve etnike a religjioze, secila me organizim të vetin intern. Apo më konkretisht, kjo formulë nuk vlenë për komunitetin lokal serb, meqë ai kontrollohet e manipulohet krejtësisht prej Beogradit. Ose, edhe më konkretisht, prej adresës Knez Mihajlova në qendër të Beogradit, ku është e vendosur SDB-ja, Shërbimi i sigurimit shtetëror - arma më besnike e regjimit të kriminelit të luftës, Slobodan Millosheviç.

Që nga i aq "Revolucioni antibyrokantik", kur oponentëve të Millosheviçit "u ndodhi populli", nëpër luftërat në Kroaci e në Bosnje, e deri në rastet e dokumentuara gjërë e gjatë në luftën e Kosovës, SDB-ja e ka përkryer deri në art kryerjen e operacioneve nën rrogë. Natyrisht, gjurmët nuk treten dot kurrë tërësisht. Por, për Beogradin mjafton që të ruhet sa të mos kapet me pelë për dore; për të tjerat kujdesen miqtë. Në rastin e Mitrovicës, fërkemët e SDB-së shihen prej së largu. Praktikisht të gjithë liderët e komunitetit serb në Mitrovicë, zz. Zhivorad Igiç, Oliver Ivanoviç, peshkopi politikan Artemie etj, të gjitha këto figura janë të njohura fort mirë për inteligjencitë perëndimore, si bashkëpunëtorë të SDB-së. Në të kaluarën, këta persona janë shërbyer me kulaç e me kërbac për ta mobilizuar komunitetin serb kundër

popullsisë rrënjëse shqiptare, jo rrallë nëpër aradha paraushtarake e në shërbimet sekrete serbe. Sot ata, të dirigjuar gjithnjë nga SDB-ja, orvaten me mish e shpirt që ta permanentojnë copëtimin *de facto* të Kosovës. Millosheviçi ia humbi Serbisë koloninë e vet, Kosovën. SDB-ja, përmes agjentëve të vet lokalë, duhet tash ta realizojë Planin B, copëtimin e Kosovës, për t'ia hapë udhën Kthimit të Madh. Ky plan është sekret publik për këdo që e njeh politikën e Beogradit. Prandaj, pastrimi etnik i Mitrovicës s'mund të konsiderohet si befasi. Njëherit, s'bën të thuhet as se ai është ekstremizëm. Për Beogradin e piunët e vet në Kosovë, pastrimi etnik i shqiptarëve, në tërësi a në pjesë, është traditë, "Procedurë standarde e operimit".

Ka indikacione të forta që flasin se ky plan po realizohet me mbështetje prej Francës, anëtare e Natos dhe një ndër fuqitë që ndërhyjnë me armë kundër regjimit të Millosheviçit, por, njëherit, aleate tradicionale e Serbisë në skemat e ndërlikuara ballkanike. Franca ka treguar rezerva të mëdha ndaj vijës amerikane gjatë luftës ajrore të Natos, duke kërkuar vazhdimisht me ngulm që Serbia të kursehet sa më shumë. Ky qëndrim francez është bërë publik pas luftës nga eprorët më madhorë amerikanë në radhët e Natos. Tash shumëkush dyshon se Franca po orvatet të udhëheqë politikë krye në vete në Siujdhesën Ilirike, për ta sabotuar Rendin e Ri amerikan në këtë nënqiell. Sipas disa burimeve unanime e të orientuara mirë, të cilat dëshirojnë të mbeten anonime, Parisi zyrtar, ndërsa nuk do dhe as nuk mundet ta mbështetë regjimin aktual serb, është tejet i interesuar t'i afrojë opozitës serbe shenja largvajtëse miqësie, shumë më amicioze se sa p.sh. që është i interesuar të japë Uashingtoni: ruajtje të qerthujve serbë në Veri, si dhe kthim relativisht të shpejtë të Kosovës në kuadër të Serbisë në rast të rrëzimit të Millosheviçit. Për Francën, që është

DRITA nr.26/2000

anëtar fuqiplotë në Nato e anëtar permanent në Këshill të sigurimit, me kontroll mbi K-Forin gjegjësisht Unmikun, këto premtime nuk janë fjalë boshe. Prandaj, dyshohet se K-Fori francez i toleron qëllimisht e me dije të plotë aktivitetet rreth Planit B në Mitrovicë. Qëllimi i Parisit është që ta kthejë planin e Millosheviçit kundër tij, duke e ngadalësuar copëtimin e Kosovës nga projekt afatshkurtë në projekt afatmesëm dhe, rrjedhimisht, në resurs të opozitës serbe; Kosova, pra, si peshqesh kurorëzimi për opozitën serbe.

Të paktë janë ata diplomatë të huaj në Kosovë që nuk e kanë kuptuar këto prapaskena në Kosovë. Ndër të painiciuarit, mjerisht, duket se bën pjesë kryeqeveritari francez i administratës ndërkombëtare, z. Bernar Kushner, burrë i përkushtuar ndaj idealeve humaniste, i njohur gjithandej për integritet të pacenueshëm personal. Por fatmirësisht, gjykuar nga reagimet e deritanishme të zyrtarëve të lartë amerikanë, prapaskenat kosovare nuk janë të panjohura për Uashingtonin. Në komentet absolutisht të para rreth ngjarjeve në Mitrovicë, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, z. Xhejms Rubin, tha se "armiqësitë në Kosovë në disa raste po stivohen hapazi prej kryetarit Millosheviç në Beograd, i cili, kur punët na shkojnë keq, ka ndjenjën se për të qenka ditë e mbarë". Ndërkaq zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, z. Xho Lokhart, u kujdes që të thotë troç se "Ne e refuzojmë kategorikisht idenë e parashtruar prej disa serbëve, se rruga e vetme për të ecur më tej qenka ndarja [e Kosovës]". Natyrisht, komente si këto s'kish se si të mos nxitin kundërveprime. Kolonel-lëjtnant francez Hening Filip, që shërben në Kosovë si zëdhënësi i Unimkut, i tuboi shpejt e shpejt gazetarët për t'u shprehur mendimin e vet, se ai vet "s'kish parë ndonjë dëshmi" (!) të infiltrimit të Beogradit ndër serbët e Kosovës, ndërsa znj. Beatrix Lakost, franceze natyrisht, zëdhënëse e Unimkut lokal në Mitrovicë, u tha gazetarëve se serbët "kanë arsye të ligjshme" që të tremben, pasi i druajnë (sic) "invazionit shqiptar". E kështu me radhë, drugëza e deklaratave vazhdon të endet para-prapa; e me të vazhdon të tjerret hollë-hollë edhe fati i Kosovës.

Ajo që është më tragjike në këtë mes është fakti se shqiptarët, viktimat e parapëlqyera në orgjitë gjenocidale të Beogradit, nuk kanë më asnjë kontroll mbi këtë lojë, që tani zhvillohet tepër lartë mbi kokat e tyre. Me përçarjen e vet kronike, krerët e politikës shqiptare e kanë

zhvlerësuar veten tmerrësisht në sytë e bashkësisë ndërkombëtare, si në Kosovë, ashtu edhe te urdhërdhënësit e tyre nëpër botë, qofshin ata miq apo skeptikë. Lajmet për "revanshizmin" shqiptar ia kanë ngrënë, njëherit, dheun nën këmbë edhe argumentit moral, që ishte bedemi i vetëm i aspiratave shqiptare në Siujdhesën Ilirike. Ndërkaq, aq sa kanë humbur autoritet jashtë shqiptarët, po aq ka imponuar përkundrazi me gjeturi e qëndrueshmëri armiku i tyre i lashtë, Serbia. Kjo është e vërteta, të cilën neve shqiptarëve na duhet thënë hapazi e në sy. Puna ka vajtur deri atje sa, në sytë e botës, fajin për trazirat në Mitrovicë e ndajnë edhe shqiptarët – ndonëse vetëm ata janë të detyruar t'i lënë shtëpitë e veta me mijëra!

Megjithatë, "arsye për panik nuk ka", përsëritin si për mësysh krerët shqiptarë. Dhe vërtetë, për sa kohë që në Uashington sundon administrata e tanishme e z. Klinton, e në krye të Serbisë kriminelit i luftës Millosheviç, ne mund të vazhdojmë të krehemi, pasi, shyqyr Zotit, nuk jetojmë të gjithë në Mitrovicë e s'na kap zjarri. Veçse ka drojë që ky ngushëllim do të na del i shkurtë. Zgjedhjet presidenciale po aviten në SH.B.A. dhe, pa marrur parasysh se kush fiton në to, prania amerikane në Kosovë do të jetë temë debatesh të forta, si në Shtëpinë e Bardhë, ashtu edhe në marrëdhëniet mes SHBA-ve dhe Francës. (Parisi zyrtar p.sh. ka kohë që e sponzoroi idenë e zëvendësimit të K-Forit me të aq Eurotrupat, *Eurocorps*, në përbërje Nato minus Amerika!) Pos kësaj, ndërrimet në përbërjen e K-Forit në Kosovë duken edhe ashtu të pashmangshme për shkak të barrës kolosale të shpenzimeve. Në fund të fundit, në Kosovë ka rrezik të mbeten vetëm ata që kanë motive regjionale, dtth evropianët.

Andaj, duket ironike por është më se e vërtetë: shqiptarët, me liderët që i kanë në krye, ka mbetur t'i luten Zotit t'ia shtojë ditët Millosheviçit, gjaksorit të tyre të vjetër. Sepse, sapo të bie ai, Serbia, me ndihmën e miqve, s'është largë meç t'i qesë tanket prapë, për t'i filladitë pak atje në Koshare, ashtu demokratikisht kuptohet, në frymën e bashkëjetesës e stabilitetit. Meqë politikanët tanë jostabilë s'jetokan dot me njëri-tjetrin, ndoshta do të mësojnë të jetojnë, sërish, dhe këtë në mënyrë bukur më stabile, me turistët serbë mbi tanke. Fundja, prova gjenerale, kallja flakë e Mitrovicës, tregoi kthjellë: shqiptarëve të përçarë, kundër serbëve e bashkësisë ndërkombëtare bashkë, nuk ua qet pazari.

kah gardiani, që po e fuste kërbacin në rryp. Ai ia bëri me dorë.

Shetitja kish mbaruar.

U kthyen rrugës së njëjtë, nëpër shkallët e mundimshme, pranë Xhekit që e ndiqte secilin hap. Pastaj, nga biruca dëgjoji se si hapeshin e mbylleshin dyert e birucave tjera, njëra pas tjetrës. Dëgjoji gjithashtu hapat e një grumbulli njerëzish, por edhe hapa të vetmuar. I ra ndër mend diçka, po qe tepër i lodhur për ta ndjekur fijen e mendimit.

Para se të shtrihej, e pa që dritarja ish pajisur me një kanate të drunjtë. Këtë e paskan futur në birucë ndërsa unë qeshë tek gjarpërinjtë, tha ai ndër dhëmbë. U gëzua, pasi tani kish mundësi ta ndalë vërshimën e ajrit të ftohtë. U ngrit dhe e mbylli dritaren me kujdes. Pas kësaj u ul prapë në dysheme. E rroku një gjumë i rëndë, i rëndë aq sa jargë të shumta i kishin rrjedhur për goje, po ky s'i kish ndjerë.

Në ndërkohë Hysiu trokiti në mur.

Arbeni u zgjua i trembur. U afrua deri te dritarja duke u kollitur. E hapi kanaten dhe fishkëlloi lehtë. Hysiu po e priste.

-Ku ishe mbrëmë?

-Mbrëmë e kam pasur një natë tepër të vështirë. M'i kanë lëshuar gjarpërinjtë nëpër trup. Pastaj më kanë rrahur me kërbac si kurrë më parë.

-Mos, more! Gjarpërinj!? A pate drojë?

-Në fillim, për pak s'vdiqa. Më vonë disi u mësova.

-Ku kështu?

-Sytë i kisha të lidhur. Por, besoj se më dërguan në burgun e Rahovecit.

-E kam ditur që në Maqedoni u lëshojnë shpesh gjarpërinj të burgosurve shqiptarë. Por, për këtu, për herë të parë po dëgjoj.

Ra një heshtje e shkurtër.

-Nejse, qoftë e shkuar! Hopa, se për pak harrova. Në nevojtohen e majtë a e more një pjesë të "Rilindjes"? E gjeta në mëngjes, gjatë shetitjes në oborr. Duket se u ka rënë kundërvajtësve.

-Të falemnderit, vëllaçko! Po, të lutem, më trego një gjë, ku e dije ti se unë do të hyja pikërisht në nevojtohen e majtë?

-Ta kam vënë veshin, ti prore shkollat aty. Asaj dere bagllamat i janë ndyshkur, ndaj edhe kërcet kur hyn dikush.

Arbeni qeshi për gjeturinë e Hysiu.

Prapë heshtje.

I mbylli kanatat e dritares.

Papritur, korridori ushtoi nga një këngë e radios serbisht, që dilte nga zëdhënësit e fuqishëm. Bariu e thirrte bareshën, po kjo bënte naze: jo, se s'më lë nëna, jo, se po dëgjon babai. Arbeni s'u lodh fort që ta kuptonte deri në fund.

Jehona e këngëve tjera baritore depërtonte edhe më fortë.

Shumë herë më parë ia kish bërë pyetjen vetes se, vallë, ç'ish ajo që e dëbonte kaq shumë nga kjo muzikë? Gjithnjë nevrkosej nga zhurma dhunuese, e njëtrajtshme, e harmonikës në vallet e këngët serbe. Këto këngë i kishin edhe tekstet pothuajse të njëjta: fillonin e mbaronin me fjalët: nëna, babai, delet, dashuria...

U afrua edhe një herë kah dritarja.

Befas, i pa disa germa të vogla në kanate. I hapi sytë për t'i shikuar edhe më mirë. Pa vështirësi e lexoi tekstin, që ish shkruar me laps, me germa të imta por me shkrim të bukur: "Bekim Koci, me datën 06. 06. 1957."

Emri i njërit prej dy mësuesve të arrestuar. Sigurisht se kjo është dita kur e arrestuan, mendoj Arbeni. U prek pamasë nga germat në kanatenë e dritares së burgut. I doli përpara fytyra e mësuesit dhe e kolegut të tij, Lydasë. Pastaj, iu bë se i pa edhe një

ushtonte tërë korridori i SPB-së. U krijua tollovi e madhe. Zbritën udbashët nga kati i dytë. Nxitueshëm zbriti edhe Mirkoja me revole në dorë dhe e vrau Litën. Edhe pse qe goditur me disa plumba dhe ishte i shtrirë i tëri i përgjakur, megjithatë nga gërmazi tij ushtonte: Li-ro-je-ni Ar-be-nin! Li-ro-je-ni Ar-be-nin! O shki-jet e zi-nj!...

-Ngritu, erdhi dreka!, u dëgjua zëri i gardianit.

Arbeni ende s'e kish marrë veten nga ankthi i ëndrrës së pakmëparshme, ndaj urdhëri i gardianit e flakëroi. I tërë trupi i dridhej nga kjo e papritur.

Gardiani nënqeshi i kënaqur. Ia hodhi një garuzhdë me lakra të grira dhe ia dha një copë bukë. Pastaj, pa fjalë e mbylli derën.

Arbeni ishte i uritur, ndaj hëngri shpejt e shpejt. E derdhi çajin në qyp dhe nga gota e plastikës piu pak ujë. Shija e ujit i erdhi si e tharbët nga klori.

E kishte tronditur ëndrra kaq shumë sa që tërë paraditen nuk iu hoq parafytyrimi i Litë Demlushit. Sidomos akti i tij trimëror, kur u vërsulej me sëpatë gardianëve. Atë ditë Arbeni u ndje tepër i pikëlluar. E dinte se vrasja e Litës ishte një ëndërr, megjithatë ishte i shqetësuar pamasë për këtë njeri guximtar...

E zgjoi rrapëllima e dyerve. Te dera e pa një gardian tjetër, i cili i foli serbisht:

-Merre qypin dhe dil përjashta!

Mezi që i mbathi këpucët, ngase këmbët iu kishin enjtur edhe më.

Bora shkelqente nga rrezet e diellit, ndonëse ishte ditë e ftohtë. Gjatë ngjites së shkallëve përpjetë, gardiani i qëndronte prapa. Arbeni e njohu këtë njeri nga nata e parë e arrestimit. Po ky gardian e kish lejuar Xhekin, qenin e burgut, që t'i hidhet në fytyrë. Tani e gërryente fytin pandërprerë dhe

pështynte zëshëm. Arbeni vërejti që e luante kërbacin me shkathtësi, duke e përdredhur atë herë djathtas e herë majtas. Si duket ka qenë bari i mirë. Kërbaçi ia kujton kërrutën. Sigurisht se së shpejti do t'ia fillojë edhe fishkëllimëve, murmuroi ndër dhëmbë.

Si ta dinte, gardiani nisi ta nanurisë ndër dhëmbë një melodi të panjohur.

Arbenit i erdhi të qeshë, por u përmbajt. Shputat e këmbëve i dhembnin gjatë ecjes, posaçërisht kur kalonte nëpër shkallë. Megjithatë, nuk ndaloi për të pushuar. Nuk e kish ndërmend ta lejojë bariun e uniformuar t'i bërtasë ose, Zot ruena!, ta mëshirojë. Megjithatë, kur erdhi te kreu i shkallëve, para derës së oborrit, nga kraharori iu shkëput një ofshe e papërmbajtshme. Më kanë këputur hu, mendoj me vete i trishtuar.

Xheki, që ishte shtrirë me të dy këmbët e hedhura përpara te dera, kësaj radhe vetëm cijati dhe i mprehu veshët, por nuk lehu. Arbeni kaloi me drojë pranë tij dhe më tej, në oborrin e burgut.

Tani rrugën për në nevojto e kishin hapur edhe më shumë. Në dëborën e shkelur shiheshin gjurmët e atyre që kishin ecur më parë. U fut në nevojto e parë të krahut të majtë. U përmbajt me djegësimë. Qypin s'pati nevojë ta zbrazë, sepse e kishte zbrazur në mëngjes. Me të dalë nga nevojtoja mori frymë thellë. E pa gardianin, që po lozte me kërbac, duke ia hedhur sytë herë pas here. Ai po e priste mbi shkallët që shpienin në birucë.

E kuptoi që ish i lirë për disa çaste. Vajti në krua për ta mbushur bokallin me ujë. Uji rridhte rrëmbyeshëm. Iu bë se e mbushi plot. Por, pas pak e vërejti se, nga shkuma, s'kish arritur ta mbushë më tepër se deri në gjysmë. E lëshoi kroin edhe një herë. Tani e mbushi deri në grykë. U drejtua

Albanska röster

FAN S. NOLI: (1882 – 1965)

ANËS LUMENJVE

*Arratisur, syrgjynosur,
Rraskapitur e katosur,
Po vajtoj pa fund, pa shpresë,
Anës Elbës, anës Spresë.*

*Ku e lam' e ku na mbeti,
Vaj-vatani e mjer' mileti,
Anës detit i palarë,
Anës dritës i paparë,
Pranë sofrës i pangrënë,
Pranë dijes i panxënë,
Lakuriq dhe i dregosur,
Trup e shpirt i saktosur,*

*Se ç'e shembnë derbederët,
Mercenarët dhe bejlerët;
Se ç'e shtypnë jabanxhinjtë,
se ç'e shtrydhnë fajdexhinjtë,
se ç'e prenë e se ç'e vranë,
ç'e shkretuan anembanë,
nënë thundren e përdhunës,
anës Vjosës, anës Bunës.*

*Çirrem, digjem, i vrerosur,
Sakatosur, çarmatosur,
As i gjall' as i varrosur,
Pres një shenj' e pres një dritë,
Pres me vjet e pres me ditë;
Se ç'u tera e se ç'u mpaka,
Se ç'u çora e se ç'u mplaka,
Larg prej vatrës e prej punës,
Anës Rinit, anës Tunës,
Çakërdisur, batërdisur,
Përpëlisur dhe zalitur,*

*Ëndërroj pa fund pa shpresë,
Anës Elbës, anës Spresë.*

*Dhe një zë vëngon nga lumi,
Më buçet, më zgjon nga gjumi,
Se mileti po gatitet,
Se tirani lebetitet,
Se pëlçet, kërcet furtuna,
Fryhet Vjosa, derdhet Buna,
Skuqet Semani dhe Drini,
Dridhet beu dhe zengjini,*

*Se pas vdekjes ndriti jeta
Dhe kudo gjëmojnë trumbeta:
Ngrhuni dhe bjeruni,
Korrni dhe shtypni,
Katundar' e punëtorë,
Që nga Shkodra gjer në Vlorë!*

*Ky ilaç e ky kushtrim
Më bën djal' e më bën trim,
Më jep forc' e më jep shpresë,*

*Anës Elbës, anës Spresë,
Se pas dimrit vjen një verë,
Që do kthehem njëherë,
Pranë vatrës, pranë punës,
Anës Vjosës, anës Bunës.*

*Arratisur, syrgjynosur,
Rraskapitur e katosur,
Brohoras me bes' e shpresë,
Anës Elbës, anës Spresë.*

FAN S. NOLI: (1882 – 1965)

VID FLODERNAS STRÄNDER

*Glömd, förtvivlad och fördriven
I min landsflykt övergiven
Sörjer jag och ropar ve
Utmed Elbe, utmed Spree*

*Sådan blev vår onda lott
Ifrån hemmet drevs vi bort,
Vi drevs bort till trista stränder
Långt från sol som hoppet tänder
Till ett liv i brist och nöd
Utan hopp och utan bröd
Skabbiga i usla trasor
Ur vårt hemlands sorg och fasor*

*Ty från skurkarnas förtryck
Kom vi hit av ödets nyck
Från ett land som lyckan glömt
Men där vi som barn har drömt
Vilka drömmar! Men var dag
Uslingar av alla slag
Plågade vårt arma land
Som är helt i bovars hand*

*Jag är utbränd och förbi
Utan kraft och energi
Lever jag? Är jag nu död?
Finns en värme, finns en glöd?
Finns ett enda hopp ett stöd?
Finns ett enda hopp, ett stöd?
Jag förtvinar år från år,
Rynkig och med gråa hår,
Här i detta fjärran land,
Kraftlös känns min kropp, min hand*

*Och jag sörjer, ropar ve,
Utmed Elbe, utmed Spree*

*Men från floden hörs ett dån
Är det vedergällningens demon?
Jag snabbt väckes ur min sömn
Men är dånet blott en dröm?
Eller är det folkets larm,
Deras upprop, deras harm?
Är det stormen som far fram
För att utplåna all skam?
Eller vilda vågor i en flod
Som bär fram förtrycktas mod
Så tyrannen drives bort
Med all smutsig byk och lort?*

*Ja, det är ett dån som ger mig hopp
Ur min vanmakt ser jag opp
Och jag glömmer svält och sår
Efter vinter kommer vår
Och då kommer vi igen
Till vår härd, ja till våran hem!*

*Och jag glömmer all min nöd
Himlen lyser varm och röd
Varm och röd, som hoppets stjärna
Som den framtid vi vill värna!
Jag får kraft och ser mig om
Mitt Albanien nu ropar: kom!
Glömd, förtvivlad och fördriven
I min landsflykt övergiven
Kan jag nu vår räddning se
Här vid Elbe, här vid Spree*

Översattes av: Ullmar Qvick
Përktheu: Ullmar Qvick

herë, nga një kënd në tjetrin.

U lodh shumë shpejt. Me përtesë u ul në dysheme. Goja i hapej pandërprerë...

Gjumi i doli vetëm kur çelësi rrapëlloi lehtas në derë. E ngriti kokën dhe e pa policin, që i fishkëllonte.

Si duket shprehinë e bariut iu paskan ngulitur thellë në ndërdije, foli për vete me inat Arbeni.

-Merre qypin e dil përjashta!

-Në qyp s'ka gjë. A mund ta lë këtu?

-Jo, duhet respektuar rregulli. Patjetër duhet të dalësh me të.

-Okej.

Bariu ia nguli sytë.

-Çka the?

-Thashë, mirë pra.

-Ngutu! Ngutu!

Ende ishte terr. Shkoi në nevojtoeren e majtë. Në këndin e djathtë, pas derës, i gjeti dy faqe të gazetës. I futi në gji. U gëzua shumë sepse, "Rilindjen" e lexonte për çdo ditë, që nga mosha dymbëdhjetëvjeçare. Në fillim i lexonte rubrikat e sportit e më vonë të gjitha me radhë, veçmas ato të kulturës.

Polici i tregoi se mbaroi shetitja. Prapë i shoqëruar nga polici dhe nën vrojtim të Xhekit, vajti deri në birucë. Shpejt e shpejt e nxorri "Rilindjen". E lexoi me kujdes një fragment të fjalimit të Titos, ku ai premtoi se së shpejti do të liberalizohet politika tatimore. Do të ketë zbritje tatimesh në shumë artikuj të konsumit të gjerë. Natyrisht, se me këto masa ekonomike do të përfitojë klasa punëtore. Te ne, thoshte Titoja, nuk ka tjetërsim të djersës e të mundit të punëtorëve. Me këto masa dëshmohet pamohueshëm përparësia e rrugës sonë vetëqeverisëse-socialiste, ku klasa jonë punëtore vendos në mënyrë demokratike mbi të gjitha çështjet fundamentale, pra edhe për të ardhurat e veta.

U sekëlldisë pamasë nga kjo hipokrizi e kulluar e Titos. I dolën parasyshtë fytyrat e Batos, Mirkos, Enverit, Zhivkos, Ibros, mustaqeziut. E hetoi se në bark filloi t'i mblidhet një nyje nga nervoza.

Askush më mirë e më qartë se i burgosuri nuk e ndjen mungesën e lirisë e demokracisë në një shtet diktatorial. Këtë njohuri ai e paguan me lëkurën e vet, por shpesh edhe me gjak.

U ngrit ngadalë i nevrkosur nga ato që i lexoi. I paloi faqet e shkëputura përsëri dhe i fshehu përfundi qypit.

Iu kujtua shkrimtari Daniel Defo e libri i tij "Robinson Kruso" si dhe vuajtjet e kryepersonazhit në ambientin e pamësuar të egërsisë. Mes atij ambienti, ku u ndodh rastësisht Robinson Kruso, dhe kësaj xhungle anticivilizuese që e ka krijuar UDB-a, me në krye prijësin e shtetit, ka dallim parimor: kjo xhungël është kriminale, sepse në programimin e saj e kanë dhënë ndihmën e tyre ekspertët e lëmive më të njohura, kurse egërsia e atjeshme është fare e pa programuar, kryekëput shprehje e shkallës së ultë të civilizimit.

Pas disa minutash u hap dera. Gardiani ia solli çajin. E provoi pak, por nuk mundi ta pij sepse qe pa sheqer.

Ishte i lodhur. U mbështet prapë për mur. Pas pak prapë e rrëmbeu gjumi. E pa një ëndërr të çuditshme: Litë Demlushi kishte ardhur pafrymë te dyert e burgut, në katin e parë dhe, me sëpatën që e kish kapur me të dy duart, thërriste me zë të çartur:

-Li-ro-je-ni Ar-be-nin se ua pres kokën! Li-ro-je-ni Ar-be-nin! Li-ro-je-ni Ar-be-nin! O shki-jet e zi-nj!...

Disa policë përpiqeshin ta ndalnin por ai i kanoste me sëpatën në duar. Ata të tmerruar zbrapseshin. Lita bërtiste, por edhe këndonte këngë patriotike. Nga zëri i tij i çjerrur

re, ai befas shtronte llojloj temash për diskutim, me qëllim që t'i angazhojë në çështje interesante. Udhëtimi netëve përveçse ishte i rrezikshëm, ai ishte edhe i mërzitshëm. Shoferi kish motiv të fuqishëm për të vepruar kësisoj. Mëditja që mirrte për secilën vozitje të besueshme gjatë natës i afrohej një të pestës së rrogës.

Ai që rrinte në të majtë të Arbenit u interesua nga fjalët e shoferit rreth trenit.

-A është çelur i tërë tuneli?

-Po. Punët janë në përfundim e sipër. Pritet që verës të lëshohet në përdorim edhe linja e re deri në Prizren.

Vozitja tani bëhej me ritëm të ngadalshëm dhe shumë e sigurtë.

Pas disa minutash Arbeni u hepua pak, në fillim përpara e më pas prapa. Nuk vonoi e xhipi zuri të ngadalësojë ritmin.

-Arritëm.

Shoferi e ndali xhipin. U dëgjuan disa dridhje të vogëla të motorit, i cili sikur nuk donte të ndalet. Dera e xhipit u hap. Arbeni e hetoi athtësinë e acarit. Nga lëvizjet e kërcitjet e borës e kuptoi se ia kishin nisur të zbresin. Dikush ia kapi krahun. Arbeni u ngrit me kujdes. Një dorë tjetër e kapi për krahun tjetër. U dëgjua zëri i shoferit të devotshëm:

-Lëshoje këmbën!

Arbeni e lëshoi së pari këmbën e djathtë, e pastaj të majtën.

Nga ushtima u kuptua se u hapën portat e hekurta. Arbenit ia mori mendja se këto mund të ishin portat e burgut të qytetit Gj. Por, nuk mund të ishte i sigurtë. Hynë brenda. Pastaj portat e hekurta u mbyllën, duke ushtuar disa herë më shumë se kur u hapen.

Ecnin nëpër çimento. Ia prekën këmbën me kërbac, si shenjë se po i afrohej një pragu. Pastaj, dikush e çeli një derë. Së pari ia hoqën shaminë

nga sytë, më pas edhe prangat.

E njohu birucën e vet. E lëshoi i habitur një psherëtimë lehtësimi, ndonëse e dinte se nuk kish pse të gëzohej.

Vajti te dritarja dhe u ul në dyshe.

Ndjehej i dërmuar nga rrahja e pagjumësia. Goja i hapej parreshtur, mirëpo nuk i flihej. Shumë pikëpyetje i ishin vizatuar në tru. Ato kërkonin përgjigje doemos. Sipas rendit të gjërave, së pari duhej ta zbrëthente një enigmë binjake, e cila që sa kohë i qëndronte e pazgjidhur mbi kokë.

Ç'ka ndodhur gjer tashti, në të vërtetë, dhe çfarë do të ndodhë tani e tutje?

Qe i molisur tejmase, ndaj ish e pamundur për t'i dhënë përgjigje të denjë kësaj pyetjeje kaq të rëndësishme. I nevojitej qetësi shpirtërore dhe përqëndrim i veçantë intelektual për t'i analizuar të gjitha ato rrethana të reja, që iu kishin imponuar gjatë orëve të fundit. Prej futjes së Çelës në birucë e deri në këtë çast, Arbeni kishte përjetuar shumëçka. Të gjitha përjetimet qenë stivuar brenda një intervali të ngjeshur kohor. Prandaj ndjehej kaq i rraskapitur. Nuk deshë të kujtohej për rrahjet fizike; kish drojë se do ta ligshntonin më shumë. Shpresoja se me daljen e Çelës kish mbaruar gjithçka, tha me vete. Doli se pas daljes së tij, situata u ngarkua edhe më tepër.

U pa puna, është kot të merresh me parashikime, i shkrepiti atypëraty.

Një trazim shqetësues e shtyu të ngritet përsëri. U çua në këmbë me ndihmën e duarve e bërrylave, që i mbështeste për mur. Ia filloi të vërtitet kujtueshëm nëpër birucë. E vërejti se iu kishin shterur gati të gjitha fuqitë trupore. Iu bë se po qëndronte mbi paterica, ndonëse ecte në këmbë të veta.

Edhe pse qe i lodhur, shetiti nja dy

KU VAJTËN ALTERNATIVAT POLITIKE !?



Shqiptar OSEKU
oseku@hotmail.com

Sh tatë muaj pas hyrjes së trupave të Natos dhe katër muaj para mbajtjes eventuale të zgjedhjeve të para vërtetë të lira, qenia politike shqiptare ka plot arsye të jetë në prag të dëshpërimit. Nuk di njeriu të qeshë a të qajë: votuesi i emancipuar në Kosovë, ndonëse i lirë, nuk ka sot ku ta hedhë votën e vet as djathtas, as majtas, pasi s'ka gjëkund as platformë të majtë, e as aso të djathtë. Në mars të vitit 2000, kur është thënë se do të mbahen zgjedhjet, qytetari kosovar rrezikon, thjesht, ta provojë një variant primitiv e gjysmëfeudal të demokracisë, ku do të detyrohet të zgjedhë mes tre – katër personave të fuqishëm, në vend se të zgjedhë mes programeve të ndryshme politike.

Natyrisht, si çdo problem, edhe ky i ka shkaqet e veta. Një vend që sapo ka dalur nga lufta e një popull që i ka shpëtuar gjenocidit për një fije floku duan kohë për të rënë në vete. Kosova, me zhvarrimet e rivarrimet e veta masive, me politikanët që ende akuzohen ndërsjelltasi për tradhëti lufte e me një mori të armëve të paligjshme, s'është në formën më optimale për zgjedhje. Zjarmia emocionale plus anarkia politike janë kombinim i rrezikshëm, e aq më tepër në një vend rural e pa traditë demokratike. Ç'është e drejta, sikur të mos ishte përngut krijimi i një administratë shqiptare para se të kryhen ndërrimet në Serbi, zgjedhjet në Kosovë do të duhej shtyer së pakut

edhe një vit, e mbase edhe më shumë. Mirëpo, si çdoherë, koha s'pret. Pas largimit të pashmangshëm të Millosheviçit nga kreu i Serbisë, gjë që mund të jetë më afër se sa mendohet, ekzistenca e një administratë të mirëfilltë

shqiptare do të jetë "të jesh, a të mos jesh" për Kosovën. Për këtë arsye, zgjedhjet duhet mbajtur patjetër, sa më shpejtë dhe me çdo kusht.

Këtë punë klasa politike kosovare e di fort mirë. Rrjedhimisht, programet e qarta do të duhej të ishin prioriteti i saj i parë. Mirëpo, në një shembull tipik të papërgjegjesisë politike, ajo këtë punë e ka vënë në bisht të sorrës. Krahët politikë kosovare as kanë prezentuar e, me sa vërehet, as e kanë ndërmend të prezentojnë ndofarë programi. LDK mbështetet plotësisht në idhujtarinë rreth z. Rugova dhe ka qejf të mendojë se është "llastare e Perëndimit". Krahu i Thaçit dhe PDK, në anën tjetër, duket se kanë vendosur t'u mëshojnë "meritave të luftës". Etiketimet rigojnë, "komunistë", "pacificistë", "tradhëtarë". Sipas matjeve herake të opinionit, në këtë "demokraci alla Indi" LDK-së po i vejnë punët ca më mirë, pasi Rugova është magnet i fortë për tërë ata që dinë veç të vëjnë gisht. Po çka e si e kanë ndërmend të bëjnë konkretisht këta zotërinj, për t'i zgjidhur nyjet e fatit të Kosovës? Asnjëri s'e di tamam. E si duket, më së paku e dinë ata vetë.

Nuk ka dyshim që, nëse punët vazhdojnë kështu, të gjithë krahët kosovarë humbin, kush më pak e kush më shumë, e fitues është vetëm Serbia e etshme për revansh. Por, humbësi absolutisht më i madh është e djathta shqiptare. Mungesa e ndarjeve të mprehta majtiste – djathtiste i intereson pikërisht të majtës, pasi ajo, për shkak të zhvillimeve globale, një matje të tillë forcash e ka të humbur që në fillim. Ajo që është tragjike – dhe habitëse! – është fakti se një platformë të besueshme s'po e përpilon dot as e djathta, edhe pse